Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

VENDIM

Data e miratimit: 05 prill 2012

Lënda nr. 197/09

Lilana SHLIVIQ-QERANIQ

kundër

UNMIK-ut

Paneli këshillëdhënës për të drejta të njeriut, në seancën e mbajtur më 5 prill 2012,
Në praninë e anëtarëve vijues:

z. Marek NOWICKI, kryesues
z. Paul LEMMENS
znj. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga
z. Andrey ANTONOV, zyrtar ekzekutiv

Pas konsiderimit të ankesës së lartpërmendur, të parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejta të njeriut, të datës 23 mars 2006,

Pas shqyrtimit, duke përfshirë edhe shqyrtimin përmes mjeteve elektronike, në përputhje me rregullën 13 § 2 të Rregullores së tij të punës, vendosë si në vijim:

I. PROCEDURA PARA PANELIT

1. Ankesa është parashtruar më 17 prill 2009 dhe është regjistruar më 30 prill 2009.

2. Më 11 qershor dhe më 17 qershor 2009, Paneli kërkoi informata shtesë nga ankuesja. Ankuesja u përgjigj më 4 prill 2010.

3. Më 23 dhjetor 2010, Paneli kërkoi nga Agjencia Kosovare e Pronave (AKP), pasardhëse e Drejtorisë Pronësore-Banesore (DPB), informata lidhur me kërkesëpadinë e ankueses të parashtruar te DPB-ja. Më 29 dhjetor 2010, AKP-ja dha përgjigjen e saj.

4. Më 23 shkurt 2011, Paneli ia dërgoi ankueses përgjigjen e AKP-së, duke e ftuar atë të japë qartësime të tjera. Ankuesja u përgjigj më 27 shkurt 2011.

II. THE FACTS

5. Ankuesja është ish-banore e Kosovës që aktualisht jeton në Serbi. Ajo deklaron se më 30 shtator 1999 prindërit e saj i ka vrarë Ushtria Çlirimtare e Kosovës në banesën e tyre në Prizren. Pas vdekjes së prindërve të saj, banesa e tyre është plaçkitur dhe më vonë është uzurpuar nga pala e tretë.

6. Më 5 maj 2002, ankuesja parashtroi kërkesëpadi tek Komisioni për Çështje Pronësore-Banesore (KÇPB) i DPB-së, ku kërkonte riposedimin e shtëpisë së prindërve të saj. Më 18 qershor 2004, KÇPB, nxori vendimin në dobi të saj, duke urdhëruar palën e paditur që ta lëshojë banesën.

7. Më 29 korrik 2005, ndaj vendimit të KÇPB-së pala e paditur ka parashtruar ankesë, duke kërkuar rishqyrtim. Kërkesa është refuzuar përmes vendimit të KÇPB-së, të datës 22 tetor 2005.

8. Më 7 shkurt, AKP-ja në cilësinë e agjencisë trashëgimtare të DPB-së ka lëshuar urdhrin për dëbim. Dëbimi është realizuar më 19 prill 2006. Në bazë të informatave të dhëna nga AKP-ja, më 2 maj 2006, ankuesja ka marrë çelësat e banesës përmes personit të autorizuar. Rasti i ankueses në AKP është mbyllur më 14 korrik 2006.

III. ANKESA

9. Ankuesja ankohet se UNMIK-u nuk ka qenë në gjendje të mbrojë pronën e prindërve të saj nga plaçkitja. Ajo gjithashtu ankohet për joefektshmërinë e procedurave para DPB-së dhe AKP-së. Mirëpo, në këtë aspekt ajo nuk japë informata se çka ka ndodhur pas dëbimit të realizuar nga AKP-ja dhe pse nuk ka mundur ta marrë banesën në riposedim.

IV. LIGJI

10. Para se të merret parasysh lënda lidhur me bazueshmërinë e saj, Paneli duhet të vendosë nëse duhet të pranohen kjo lëndë, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë, të paraqitura në nenet 1, 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

A. Ankesa për plaçkitjen e pronës

11. Në bazë të nenit 2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, Paneli ka juridiksion ndaj ankesave lidhur me shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut që kanë ndodhur jo më herët se më datën 23 prill 2005 apo që rrjedhin nga faktet që kanë ndodhur para kësaj date, në rast se këto fakte çojnë në shkeljen e vazhdueshme të të drejtave të njeriut.

12. Sa i përket ankesës së ankueses për plaçkitjen e banesës së prindërve të saj, Paneli thekson se plaçkitja pretendohet të jetë bërë në vitin 1999. Për më tepër, Paneli konsideron se shkatërrimi i pronës është vepër e atypëratyshme, që nuk ka si rrjedhojë shkeljen e vazhdueshme (shih Paneli këshillëdhënës për të drejta të njeriut, *Llajoviq*, nr. 09/08, vendim i datës 16 korrik 2008, § 7).

13. Nga kjo rrjedh se kjo pjesë e ankesës mbetet jashtë juridiksionit *ratione temporis* të Panelit.

B. Ankesa për procedurat para DPB-së dhe AKP-së

14. Në pajtim me nenin 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, Paneli shpall të papranueshme çdo ankesë, të cilën e konsideron në mospërputhje me instrumentet e të drejtave të njeriut brenda juridiksionit të Panelit apo të cilën e konsideron si të pabazuar.

15. Lidhur me procedurën para DPB-së dhe AKP-së, Paneli konstaton se ankesa nuk paraqet hollësi apo informatat specifike, që do t'ia mundësonin Panelit të vlerësojë nëse UNMIK-u ka bërë shkelje të të drejtave të njeriut.

16. Brenda këtyre rrethanave, Paneli konstaton se kjo pjesë e ankesës nuk është e argumentuar dhe rrjedhimisht është e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, njëzëri,

SHPALL ANKESËN SI TË PAPRANUESHME.

Andrey ANTONOV
Zyrtar ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryesues